




RAPORT I PËRVJETSHËM PËR ZHVILLIMET NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE BARAZISË GJINORE NË KOSOVË

2023

qika

Përmbajtja

Hyrje.....	5	Dhuna me bazë gjinore	20
Përmbledhje ekzekutive	7	Dhuna në familje ndaj grave	22
Qasja në punësim	9	Të mbijetuarat e dhunës në familje..	22
Puna e papaguar e grave.....	12	E drejta në kompensim	29
Pushimi prindëror	13	Dënimet e ulëta ndaj abuzuesve të grave.....	29
Qasja në pronë.....	15	Dhuna seksuale.....	31
Qasja në shëndetësi.....	16	Dhunimi seksual.....	34
E drejta në shëndet riprodhues dhe seksual.....	16	Dhuna seksuale gjatë luftës.....	34
Diskriminimi i ndërthurur	18	Ngacmimet seksuale.....	35
Gratë e komuniteteve etnike pakicë ..	18	Dhuna përmes teknologjisë informative.....	37
Gratë LGBTI+	18	Gratë në sferën publike.....	37
Gratë me aftësi të kufizuara.....	19	Femicidi	39
Gratë me shami	19	Rastet e zgjidhura të femicidit.....	40
		Rastet e pazgjidhura të femicidit...	43

AUTORE: Rina Kika

© Ky publikim është prodhuar nga Qendra për informim, Kritikë dhe Aksion – QIKA, 2024

Hyrje

Ky raport ofron një pasqyrim gjithpërfshirës të ngjarjeve, zhvillimeve dhe të dhënave kyçe për vitin 2023 në fushën e drejtësisë dhe barazisë gjinore. Raporti mbulon zhvillimet që kanë të bëjnë me barazinë sociale, politike dhe ekonomike të grave në Kosovë. Qëllimi i raportit është që ta bëjë më të qasshëm monitorimin e zhvillimeve për publikun, për hulumtues/e, gazetarë/e që raportojnë, shkruajnë, e angazhohen për çështje gjinore, për persona në pozita vendimmarrëse apo për këdo që ka interesim. Zhvillimet përfshijnë aspekte të ndryshme të të drejtave ekonomike, sociale e politike të grave të mbrojtura me Kushtetutën e Kosovës dhe konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Raporti mbështetet në rishikimin e dokumenteve ekzistuese publike, raporteve të shoqërisë civile, raporteve në medie, vendimeve gjyqësore, vendimeve tjera institucionale, akteve ligjore dhe nënligjore, të dhënave të siguruar nga 11 kërkesa për qasje në informata zyrtare, si dhe të dhënave të tjera zyrtare.

Një pengesë gjatë mbledhjes së informatave ishte mungesa e të dhënave zyrtare të ndara sipas gjinisë dhe etnisë. Prokuroria e Shtetit i ofroi vetëm numrat e përgjithshëm të rasteve për vitin 2023, pa i zbërthyer sipas gjinisë. Mungesa e të dhënave sipas gjinisë pengon monitorimin dhe analizimin dimensionit gjinor brenda fushës së veprimit të institucioneve, cilat do qofshin ato. Mbledhja adekuate dhe sistematike e të dhënave lidhur me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore njihet si element thelbësor për krijimin e politikave për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore.¹ Përpos kësaj, mungesa e të dhënave të zbërthyera në bazë të gjinisë bie ndesh me detyrimet nga Konventa e Stambollit ku përcaktohet se shtetet obligohen të mbledhin të dhëna statistikore në intervale të rregullta të zbërthyera në bazë të gjinisë, për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.² Në anën tjetër, Agjencia e Statistikave të Kosovës edhe pse të dhënat në Anketën e Fuqisë Punëtore i ndan sipas gjinisë dhe grupmoshës, nuk i ndanë të dhënat sipas etnisë. Një ndarje e tillë do të mundësonte një analizë më gjithpërfshirëse e me nuanca.

1 Këshilli i Evropës, Raporti spjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, faqe 14, <https://rm.coe.int/1680a48903>.

2 Këshilli i Evropës, Konventa e Stambollit, neni 11; Këshilli i Evropës, Explanatory Report to the Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, Faqe 14, <https://rm.coe.int/1680a48903>.

SHITET!




SHITET
PRIVAT

VRASËSIT
E GRAVE
NË BURG

GIYKATAT --
ARMIKE
TË GRAVE

TEK NE,
VRASËSI
ËSHTE EDHE
KILLER

N' MA
SIGURI



NUK KA PAQE
DA SIGURINË E GRAVE

Përmbledhje ekzekutive

- Kuvendi miratoi Ligjin e ri për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Urdhrat mbrojtës u bënë të qasshëm edhe për të mbijetuarat e dhunës seksuale që nuk kishin lidhje qoftë familjare apo tjetër me abuzuesit. Ndryshimet e Kodit Penal kriminalizuan testimin e virgjërisë. Për herë të parë, personat LGBTQ+ u njohën ligjërisht si viktime të ndjeshme.
- Qeveria rriti dukshëm buxhetin për vitin 2023 për strehimoret për gra dhe fëmijë të mbijetuar të dhunës në familje, pas kërkesave të shumta të strehimoreve dhe të organizatave për të drejtat e grave. Megjithatë, një zgjidhje afatgjatë e problemit me financimin e strehimoreve, përtej vitit 2023, mungoi.
- Gjykata Themelore në Prishtinë i dha të drejtë Luljeta Aliut dhe konstatoi se Policia e kishte diskriminuar në bazë të gjinisë kur nuk ia kishte regjistruar denoncimin ndaj ish-bashkëshortit për shkelje të urdhrit mbrojtës.
- Rifilloi gjykimi ndaj Syzana Zogëjani Sekiraqës, e mbijetuar e dhunës në familje, e dënuar paraprakisht me 25 vite burgim për vrasjen e bashkëshortit të saj, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese që konstatoi shkelje të të drejtave të saj si e akuzuar.
- Gjatë vitit 2023, gratë në Kosovë vazhduan të kenë nivele të ulëta të punësimit formal krahasuar me burrat. Ndarja e pabarabartë e punëve të shtëpisë dhe të kujdesit ndaj familjes në mes të grave dhe burrave vazhdoi ta rëndonte qasjen e grave në tregun e punës dhe fuqizimin e tyre ekonomik. Qeveria miratoi masën për punësimin e të mbijetuarave të dhunës në familje që do të subvenciononte 70% të pagës së grave, mirëpo nuk ofroi informata se sa gra kanë përfituar nga kjo masë.

- Niveli i zotërimit të pronave nga gratë vazhdoi të ishte shumëfish më i ulët në krahasim me burrat, ku vetëm 15% të pronave zotëroheshin nga gratë në krahasim me 74% që zotëroheshin nga burrat.
- Gratë e verbra u ballafaquan me mungesë të vazhdueshme të qasjes në informata dhe teknologji, si dhe nivel të lartë të analfabetizmit.
- Produktet menstruale vazhduan të taksoheshin si produkte luksi me 18% tatim mbi vlerën e shtuar.
- Dështimi i miratimit të Ligjit për Fertilizimin e Asistuar Mjekësor ia mohoi grave qasjen në këtë shërbim në spitale publike. Fertilizimi i Asistuar Mjekësor vazhdoi të ishte i qasshëm vetëm në spitale private si shërbim me çmim të lartë.
- Strehimi dhe punësimi vazhduan të ishin pengesa qenësore në rrugëtimin e të mbijetuarave të dhunës në familje për të jetuar një jetë të lirë nga dhuna.
- Gjykatat vazhduan të mos e shfrytëzojnë bazën ligjore për t'i dhënë kompensim të dëmit të shkaktuar nga dhuna në familje të mbijetuarave të dhunës në familje brenda procedurës penale.
- Nuk pati zhvillime për hapjen e një strehimoreje për personat LGBTQ+ që përjetojnë dhunë në familje.
- Kodi Civil sërish nuk u soll më në votim para Kuvendit, pasi dështoi të miratohej në mars 2022. Çiftet e seksit të njëjtë nuk gëzuan mbrojtje dhe njohje ligjore të lidhjes së tyre dhe vazhduan të mos kenë të drejtë të trashëgojnë nga njëri/a-tjetri/a.
- Gjatë vitit, katër gra u vranë nga burrat, ndërsa pati pak zhvillime pozitive në gjetjen dhe sjelljen para drejtësisë të vrasësve të tyre. Nuk pati zhvillime për gjetjen e vrasësit të Donjeta Pajazitajt, e cila u vra në vitin 2015 dhe u gjet në Bjeshkët e Strellcit. Nuk pati zhvillime për gjetjen e vrasësit të Diana Kastratit e cila u vra në vitin 2011 në Prishtinë ndërsa i dyshuri kryesor, ish-bashkëshorti i saj është ende në arrati. Nuk pati zhvillime për gjetjen e Mirjeta Zekës, e cila është e zhdukur që nga viti 2019 në Mitrovicë dhe i dyshuari kryesor për zhdukjen e saj është bashkëshorti i saj.

Qasja në punësim

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm 19,6% të grave ishin formalisht të punësuar, krahasuar me 53,1% të burrave.³ 72.2% e grave ishin jo aktive në tregun e punës krahas 43.6% të burrave. Nga të gjitha ndërmarrjet aktive në vitin 2023, vetëm 23,7% kishin pronare gra, në krahasim me 72% që kishin pronarë burra.⁴ Këto të dhëna nuk janë të ndara sipas etnisë, prandaj nuk mund të konstatohet se sa gra nga komunitetet pakicë ishin të punësuar në krahasim gratë tjera. Shumica e personave të punësuar punonin me orar të plotë, ndërkaq arsyet për punën me orar të pjesshëm dallonin tek burrat dhe gratë. Gratë raportonin se punojnë me orar të pjesshëm për shkak se të kujdesit ndaj familjes, ndërkaq burrat për shkak të mungesës së gjetjes së një pune me orar të plotë.⁵ Pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali në Kosovë vazhduan të përballen me pengesa në qasjen në punësim dhe edukim, si dhe përfaqësim të ulët në institucione.⁶

Një hulumtim mbi diskriminimin me bazë gjinore në shpalljet e vendeve të lira të punës i publikuar nga Instituti GAP, gjeti se shumë shpallje për pozita të punës përmbanin stereotipe gjinore. Për shembull shumë prej tyre ishin shkruar në gjuhë të kodifikuar mashkullore si: punëtor, drejtor, menaxher ose gjuhë të kodifikuar femërore: asistente, shitëse, edukatore. Ky hulumtim analizoi 6,225 shpallje për vende të lira të punës të publikuara në platformën “Kosovajob” gjatë vitit 2022, si dhe 1,357 shpallje për vende të lira të punës të publikuara në platformën “Superpuna”, e lansuar në shkurt 2023 nga Ministria e Financave, Punës, dhe Transfereve.⁷

3 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore TM2 2023, 7 shkurt 2024, faqe 13, 10 prill 2024,

4 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Reporteri Statistikor i Ndërmarrjeve, TM4 2023, <https://askapi.rks-gov.net/Custom/b7159f1b-a7c9-41d5-bca7-8ea404928a6c.pdf>

5 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore TM1 2023, 7 shkurt 2024, faqe 11, <https://askapi.rks-gov.net/Custom/ae5403d1-c2af-429a-976f-90b95713f095.pdf>

6 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2023, 8 nëntor 2023, faqe 5, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

7 Instituti GAP, Diskriminimi me bazë gjinore në shpalljet e vendeve të lira të punës, prill 2023, https://www.institutigap.org/documents/43654_diskriminimi_shpalljet_.pdf

Në tremujorin e dytë të vitit 2023,
sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës

19,6%

të grave ishin formalisht të punësuar,
krahasuar me **53,1%** të burrave.

Nga të gjitha ndërmarrjet aktive në vitin
2023, vetëm

23,7%

kishin pronare gra, në krahasim me **72%** që
kishin pronarë burra.

Në shtator, u raportua për tri gazetarë gra me përvojë shumëvjeçare që nuk u përzgjedhën në RTK për pozita menaxheriale, pavarësisht se ishin më të poentuarat në konkurset e hapura. Gazetarët kishin treguar edhe për presionin që i ishte bërë për t'i bindur të tërhiqeshin nga gara.⁸ Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e cilësoi këtë si diskriminim në bazë të gjinisë.⁹ Bordi i RTK-së i cilësoi denoncimet për diskriminim gjinor si “sulme të grupeve të interesit”.¹⁰

8 Kallxo.com, Radio Televizioni i Burrave, 1 shtator 2023, <https://kallxo.com/gjate/radio-televizioni-i-burrave/>

9 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, AGK-ja, e zhgënjyer me diskriminimin gjinor në pozitat menaxheriale në RTK, 9 shtator 2023, <https://www.facebook.com/photo/?fbid=695745225924221&set=a.627995876032490>

10 Kallxo.com, Bordi i RTK-së i quan sulme të grupeve të interesit denoncimet për diskriminim gjinor në mediumin publik, 13 shtator 2023, <https://kallxo.com/lajm/bordi-i-rtk-se-i-quan-sulme-te-grupeve-te-interesit-denoncimet-per-diskriminim-gjinor-ne-mediumin-publik/>

Puna e papaguar e grave

Një anketë me 111 pjesëmarrës nga Demokracia për Zhvillim tregoi se gratë shpenzojnë 7.2 orë në punët e shtëpisë dhe të kujdesit në familje krahasuar me 2.5 orë që i shpenzojnë burrat. Sipas raportit, puna e papaguar që gratë e kryejnë për çdo ditë i mban ato larg tregut të punës dhe punës me pagesë dhe mes tjerash, e pengon fuqizimin e tyre ekonomik, pjesëmarrjen në jetë publike dhe e bën kontributin e tyre të mbetet i padukshëm dhe i pallogaritur.¹¹




11 Demokraci për zhvillim (D4D), Ekonomia e nënvleftësuar «Gratë nuk kanë kohë ta ndryshojnë kombin: janë të zëna me punët e shtëpisë», 2023, faqe 16, https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/Underrated_Economy_ALB_web.pdf

Pushimi prindëror

As në vitin 2023 nuk u miratua Ligji për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror dhe as Ligji i ri i punës që planifikohet ta rregullojë mundësinë që gratë, të mund t'ia bartin pushimin e tyre të lehonisë baballarëve, mundësinë e marrjes së pushimin e atësisë, kompensimin e pushimit të lehonisë për gratë e vetpunësuar, e me radhë.¹² Një sondazh me 1065 persona nga Instituti Musine Kokalari tregoi se 72% e burrave të anketuar dhe 72% e grave mendojnë se pas lindjes së foshnjës, baballarët duhet të marrin pushim prindëror katër deri në gjashtë muaj, nëse nuk do të kishin pasoja në vendin e tyre të punës dhe nëse qeveria do ta përkrahte financiarisht pushimin prindëror.¹³

72% e burrave të anketuar dhe **72% e grave** mendojnë se pas lindjes së foshnjës, baballarët duhet të marrin pushim prindëror katër deri në gjashtë muaj, nëse nuk do të kishin pasoja në vendin e tyre të punës dhe nëse qeveria do ta përkrahte financiarisht pushimin prindëror.

72%



Sondazh me 1065 persona nga
Instituti Musine Kokalari

12 Kosovo 2.0, Ligji i Stërvjetëruar i Punës, 29 nëntor 2023, <https://kosovotwopointzero.com/ligji-i-stervjetëruar-i-punes/> Zyra e Kryeministrit, Konsultimi Publik, Ligji për Pushimin e Lehonisë dhe Pushimin Prindëror, 03.10.2018, (qasur me 4 mars 2024) <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40486>

13 Instituti Musine Kokalari, Qëndrimet e kosovarëve lidhur me pushimin prindëror për prindin baba, nëntor 2023, <https://musineinstitute.org/qendrimet-e-kosovareve-lidhur-me-pushimin-prinderor-per-prindin-baba/>

~~PSIKOPAT~~
PATRIARKAT

MA NUK DO THESHTIM
DERI N FRYMËN E
FUNDIT DO
T REZISTOJMË!


KY PATRIARKAT
I KA
ME GJAK

NBURG
E JO
N PSIKIATRI!

NYN' MA
SIGURI
ATUSA

Qasja në pronë

Një hulumtim nga GAP tregoi se vetëm 15% të pronave zotëroheshin nga gratë në krahasim me 74% të burrave. Pjesa e mbetur e pronave ishin në pronësi të personave juridik. Vetëm 16% të llogarive bankare të biznesit ishin në pronësi të grave, në krahasim me 82% zotëroheshin nga burrat.¹⁴ Zotërimi i ulët i pronave nga gratë shkakton probleme të ndryshme ekonomike e shoqërore për gratë si për shembull mungesa e kolateralit të mjaftueshëm për të marrë hua që do t'ua mundësonte zhvillimin e bizneseve të tyre.¹⁵



¹⁴ Instituti GAP, Në kërkim të barazise financiare: Qasja në financa për bizneset në pronësi të grave dhe të pakicave etnike, nëntor 2023, faqe 4, https://www.institutigap.org/documents/85617_Qasja%20n%C3%AB%20financa%20p%C3%ABr%20bizneset%20n%C3%AB%20pron%C3%ABsi%20t%C3%AB%20grave%20dhe%20pakicave%20etnike%20f.pdf

¹⁵ Kosova Women's Network, Analiza Gjimore 2018, <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

Qasja në shëndetësi

E drejta në shëndet riprodhues dhe seksual

Produktet menstruale vazhduan të taksoheshin si produkte të luksit me 18% tatim mbi vlerën e shtuar. Në maj, organizata QIKA bëri thirrje publike për heqjen e tatimit mbi vlerën e shtuar për produktet menstruale dhe hapi peticion online për nënshkrim. Peticioni u nënshkrua nga 7,500 persona.¹⁶

Shfrytëzimi i metodës së Fertilizimit të Asistuar Mjekësor (FAM) për shtatëzani ishte i qasshëm vetëm në spitale private. Për pasojë, qasja në këtë shërbim vazhdoi të pengohej për gratë të cilat nuk kishin mundësi të paguajnë çmimet e larta të spitaleve private. Kuvendi i Kosovës, në tetor vendosi në votim Ligjin e ri për Shëndetin Riprodhues ku parashihet që Fertilizimi i Asistuar Mjekësor të ofrohet nga spitalet publike, të gjitha gratë mbi 18 vjeç, pavarësisht nga statusi martesor. Disa deputetë e kundërshtuan nismën për mundësimin e këtij shërbimi për të gjitha gratë pa dallim.¹⁷ Në tetor ky ligj u votua vetëm në lexim të parë pas tri dështimesh por, dështoi të miratohej sërish në shkurt 2024, për shkak të mungesës së kuorumit dhe mungesës së deputetëve të opozitës në sallë.¹⁸

16 Qika.org, Nënshkruaj peticionin për heqjen e tvsh-së për produkte menstruale, <https://qika.org/activities/nenshkruaj-peticionin-per-heqjen-e-tvsh-se-per-produkte-menstruale/>

17 Radio Evropa e Lirë, Kuvendi miraton projektligjin për shëndetin riprodhues, 4 tetor 2023, <https://www.evropaelire.org/a/kuvne-di-miraton-projektligjin-shendetin-riprodhues/32623015.html>

18 Koha net, Dështon sërish projektligji për IFV-në, deputetët e pushtetit të ndarë, 22 shkurt 2023, <https://www.koha.net/lajmet-emblemjes-ktv/410276/deshton-serish-projektligji-per-ivf-ne-deputetet-e-pushtetit-te-ndare>



Diskriminimi i shumëfishtë dhe i ndërthurur

Gratë e komuniteteve etnike pakicë

Zyra për Qeverisje të Mirë lansoi Platformën Kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.¹⁹ Gjatë vitit u raportuan 23 raste të diskriminimit.²⁰ Të dhënat e Qeverisë nuk specifikojnë se çfarë ankesash ishin ose ndaj kujt ishin parashtruar ato. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën thekson se martesat e fëmijëve, ato të hershme dhe martesat me dhunë vazhdojnë të jenë problem në Kosovë, posaçërisht tek komunitetet rom dhe ashkali.²¹

Gratë LGBTI+

Qeveria nuk e dërgoi sërish për votim në Kuvend Projekt-Kodin Civil që do ta trasonte udhën për rregullimin ligjor të bashkësive civile të personave me seks të njëjtë me ligj të veçantë. Diskutimi në Kuvend për Kodin Civil ishte përcjellë me gjuhë homofobike dhe përjashtuese.²²

Nuk pati zhvillime domethënëse për hapjen e strehimores për personat LGBTI në Kosovë, përkundër zotimeve të Komunës së Prishtinës dhe të Qeverisë për ndërtimin dhe hapjen e saj.

19 Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, <https://raportodiskriminimin.org/> (qasur me 15 maj 2024).

20 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2023, 8 nëntor 2023, faqe 36, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

21 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2023, 8 nëntor 2023, faqe 38, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

22 Radio Evropa e Lirë, Projektkodi Civil nuk kalon në parim, 16 March 2022, <https://www.evropaelire.org/a/bashkesite-civile-projekt-kodi-/31756223.html>

Gjetjet nga një raport i Amnesty International tregojnë se, për shkak të mungesës së strehimores në Kosovë, personat LGBTI në Kosovë detyrohen të kërkojnë strehim në Shqipëri, që nuk është çdo herë i mundshëm.²³

Personat transgjinnorë në Kosovë vazhduan të mos kenë qasje në qendrat dhe klinikat e specializuara që ofrojnë kujdes shëndetësor për ofrimin e terapisë hormonale apo të operacioneve kirurgjike për afirmimin e gjinisë. Shumë prej tyre u detyruan të udhëtojnë në Maqedoninë e Veriut për të pasë qasje në terapisë hormonale, që paraqet një barrë të madhe financiare për personat transgjinnor. Profesionalistët shëndetësorë në Kosovë kishin nevojë për trajnime të specializuara për të ofruar shërbime adekuata për personat transgjinnorë.²⁴

Gratë me aftësi të kufizuara

Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës raportoi se gratë e verbra vazhdojnë të ballafaqohen me mungesë të vazhdueshme të qasjes në informata dhe teknologji dhe se “niveli i lartë i analfabetizmit tradicional dhe atij të përdorimit të teknologjisë ka ndikuar në segregimin e plotë të grave dhe vajzave të verbra”.²⁵

Gratë me shami

Në korrik, Liman Bytyçi u deklarua i pafajshëm ndaj akuzës së prokurorisë për veprën penale “shkelje e statusit të barabartë të shtetasve të Republikës së Kosovës”.²⁶ Bytyçi, në cilësinë e drejtorit të shkollës fillore të mesme të ulët “Flamuri i Arbërit” në Komunën e Suharekës kishte nxjerrë vendim për t’ia ndaluar mësimdhënien mësueses së matematikës Ramize Elezi pasi ajo kishte vendosur të bartte shaminë.²⁷ Në kohën e shkrimit të raportit nuk u raportua për zhvillime të reja lidhur me procesin gjyqësor.

23 Amnesty International, Nga Letra në Praktikë: Kosova duhet t’i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje, <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7123/2023/en/>

24 OJQ CEL, Kujdesi Shëndetësor për Personat Trans në Kosovë – Sfodat dhe perspektivat ligjore, nëntor 2023, faqe 8-10, 12, <https://cel-ks.org/wp-content/uploads/2023/11/Kujdesi-shendetesor-per-personat-trans-ne-Kosove-Sfodat-dhe-perspektivat-ligjore.pdf>

25 Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës, 20 dhjetor 2023, <https://fb.watch/pKopSjxG4G/>; Shih po ashtu: Komiteti i Grave të Verbëra, Situata e Grave dhe vajzave të verbëra dhe me të pame të dobësuar, korrik 2022, <https://kgv-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/KGV-Hulumtimi-Shqip-.pdf>

26 Kallxo.com, Shkaku i shamisë mësueses në Suharekë iu ndalua hyrja në shkollë, ish-drejtori i akuzuar del para gjyqit, 27 korrik 2023, <https://kallxo.com/lajm/shkaku-i-shamise-mesueses-ne-suhareke-iu-ndalua-hyrja-ne-shkollë-ish-drejtori-i-akuzuar-del-para-gjyqit/>; Shih po ashtu: Kallxo.com, Shkaku i shamisë mësueses në Suharekë nuk po i lejohet të hyjë në shkollën ku ajo jep mësim, 9 shtator 2022, <https://kallxo.com/lajm/shkaku-i-shamise-mesueses-ne-suhareke-nuk-po-i-lejohet-te-hyje-ne-shkollën-ku-ajo-jep-mesim/>

27 Po aty.

Dhuna me bazë gjinore

Në shtator, Kuvendi miratoi Ligjin e ri për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Ky ligj zëvendësoi dhe shfuqizoi Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje që ishte në fuqi që nga viti 2019. Mes tjerash, ligji i ri parasheh disa risi të rëndësishme për mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës në familje duke përfshirë:

- 1 përcaktimin e qartë se “dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore është shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe përbën diskriminim”;
- 2 përkufizon qartë se çka është dhuna ekonomike, dhuna psikologjike, kontrolli i vazhdueshëm, ngacmimi seksual përmes internetit;
- 3 i njeh për herë të parë si viktimë të ndjeshme edhe personat LGBTQ+;
- 4 përcakton se shërbimet shtetërore duhet t’i përshtaten nevojave specifike të viktimave;
- 5 përcakton që Ministria e Arsimit duhet të përfshijë në “kurrikulën e niveleve parauniversitare të arsimit tema që promovojnë barazinë gjinore, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, respektimin e diversitetit, njohuri mbi identitetin gjinor, format e dhunës me bazë gjinor dhe edukimin gjithpërfshirës seksual”;
- 6 mbështetjen e strehimoreve të specializuara me buxhet të qëndrueshëm për së paku tri vite;
- 7 viktimave të dhunës në familje u lejohet të marrin 15 ditë kalendarike pushim të paguar në punë, për adresimin e problemeve shëndetësore, ligjore, ndrrim të vendbanimit e të tjera dhe mund të kërkojnë një vit pushim pa pagesë në punë.²⁸

Në nëntor, Qeveria lansoi për herë të parë Programin kombëtar për kryrësit e dhunës ndaj grave.²⁹ Mbeten të shihen rezultatet që do t’i sjellë ky program në rehabilitimin e kryesve të dhunës dhe parandalimin e kryerjes së mëtejshme të dhunës.

28 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83131>

29 Ministria e Drejtësisë, Raport përmbledhës i fushatës «16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore 2023», janar 2024, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/E732F69C-56BD-4CEC-ABEA-04BE3F757839.pdf>

**SHTETI FAJTOR
PËR VRASJEN E
SEBAHATE MORINËS**

Dhuna në familje ndaj grave

Përgjatë vitit 2023 në Policinë e Kosovës janë raportuar 2,460 raste të dhunës në familje, ku prej tyre 2,120 ishin viktime gra dhe 597 burra.³⁰

Prokuroria kishte ngritur aktakuzë në 1478 raste ndaj personave madhor për dhunë në familje. Nga rastet e përfunduara, sipas Prokurorisë 1483 vendime fajësuese për dhunë në familje, janë refuzuar 21 aktakuza, ndërsa 18 persona janë liruar nga akuza, si dhe janë shqiptuar 150 masa per trajtim të detyrueshëm. Në gjithsej nëntë raste të dhunës në familje gjykatat kanë marrë vendim refuzimit të aktakuzës për të shkak të parashkrimit.³¹ Të dhënat nga prokuroria ishin nuk ishin të ndara sipas gjinisë. Kjo paraqet mangësi në publikimin e të dhënave dhe e pengon analizën dhe monitorimin e punës së prokurorisë në lidhje me dhunën me bazë gjinore.

Të mbijetuarat e dhunës në familje

Qasja në informata


Të mbijetuarat e dhunës në familje me bazë gjinore nuk patën qasje në një linjë telefonike të veçantë pa pagesë përkundër premtimit të Qeverisë për ta funksionalizuar atë dhe detyrimin nga Konventa e Stambollit e zbatueshme në Kosovë nga viti 2020.³²

30 QIKA, Përgjigje e Policisë së Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 26 mars 2024.

31 QIKA, Përgjigje e Prokurorisë së Shtetit ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 23 shkurt 2024.


32 Ministria e Drejtësisë, Raport vjetor i zbatimit të strategjisë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, faqe 9, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/E8D81979-55CD-4A96-A212-22449E90BE9C.pdf>. Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/FE2B3346-A26C-449E-A903-A8290C138A0B.pdf>, faqe 115, Konventa e Stambollit, neni 24. Radio Evropa e Lirë, Konventa e Stambollit përfshihet në Kushtetutën e Kosovës, 25 shtator 2020, <https://www.evropaelire.org/a/30858218.html>

Përgjatë vitit 2023 në Policinë e Kosovës janë
raportuar **2,460** raste të dhunës në familje



2,120

viktima gra



597

viktima burra

Fushatat informuese për dhunën me bazë gjinore u përqëndruan kryesisht gjatë 16 ditëve të aktivizmit ndaj dhunës me bazë gjinore. Përmes publikimit të numrit të Policisë, fushatat informuese i inkurajuan qytetarët/et t'i raportojnë rastet në Polici. Ndërkaq, informatat për shërbimet tjera mbështetëse, përfshirë strehimoret, mbrojtësit e viktimave, qendrat për punë sociale, ndihma ligjore falas, e me radhë, ishin të pakta.³³

Qasja në drejtësi

Shumica e të mbijetuarave të intervistuar nga Amnesty International thanë se zyrtarët policorë i kishin trajtuar me nënçmim përvojat e tyre dhe ishin prirur t'i merrnin seriozisht vetëm kur kishin shenja të dukshme të dhunës. Veçanërisht të mbijetuarat që ishin gra transgjinore raportuan të jenë trajtuar me mosbesim, paragjyime dhe keqtrajtim nga policia.³⁴

Luljeta Aliu

Në prill 2023, Luljeta Aliu fitoi rastin në gjykatë ndaj Policisë për diskriminim në bazë të gjinisë. Gjykata Themelore në Prishtinë konstatoi se Policia e kishte diskriminuar Luljetën kur kishte refuzuar ta regjistronte raportimin e saj ndaj ish-bashkëshortit me arsyetimin se ajo kishte veshur “një fustan tejet të shkurtër dhe një maicë me rripa”. Megjithatë, Gjykata nuk e vendosi lëndën përfundimisht por e dërgoi për rivendosje të Policia. Nuk pati vendim përfundimtar lidhur me përgjegjësinë disiplinore të zyrtarëve policorë.³⁵

Syzana Zojëjani Sekiraqa

Në gusht 2023, Gjykata Kushtetuese ktheu në rigjykim lëndën e akuzës për vrasje ndaj Syzana Zojëjani Sekiraqës duke i anuluar aktgjykimet e Gjykatës Themelore, të Apelit dhe Supremes që ia kishin shqiptuar 25 vjet burgim për vrasjen e bashkëshortit. Kushtetuesja konstatoi shkelje të të drejtës së

33 QIKA, Rishikim i materialeve gjatë fushatës 16 ditët e aktivizmit ndaj dhunës ndaj grave, dhjetor 2023.

34 Amnesty International, Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje, faqe 33-40, <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7123/2023/en/>

35 Qika.org, Luljeta Aliu fiton rastin në gjykatë ndaj Policisë, 19 prill 2023, <https://qika.org/luljeta-aliu-fiton-rastin-ne-gjykatë-ndaj-policisë/>

Syzanës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm mes tjerash për shkak se 1) gjykatat nuk kishin ndërmarrë veprime procedurale që t'i mundësohet të akuzuarës marrja në pyetje e dëshmitarëve por vetëm ishin lexuar dëshmitë e tyre; 2) gjykatat kishin refuzuar kërkesën e saj që të merren dëshmitë që vërtetojnë se ajo ishte viktimë e dhunës në familje; dhe 3) gjykatat vazhdimisht e kishin refuzuar kërkesën e saj për ekzaminim psikiatrik; 4) gjykata kishte përdorur gjuhë paragjyquese ndaj të akuzuarës në vendim. Konkretisht në vendim thuhet "Përderisa vet [parashtruesja e kërkesë- rrëfen një skenar të një ngjarje të pa qenë kinse me abuzimin e të miturit, e që vërtetë edhe Hiqkoku do ia kishte zili të njejtës për ndër- timin e një skenari të tillë imagjinar".³⁶

Syzana Zogëjani Sekiraqa është e mbijetuar e dhunës në familje nga bashkëshorti i saj Artan Sekiraqa. Nga viti 2007 deri në vitin 2018 ajo kishte raportuar dhunën që po e përjetonte fillimisht para autoriteteve në Kosovë e pastaj në Francë, ku në kohë të ndryshme nga viti 2010 deri në vitin 2018 kishte kërkuar strehim për vete dhe për fëmijët. Në vitin 2018, Artan Sekiraqa ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar për dhunë në familje nga Gjykata në Lion të Francës dhe ishte liruar me kusht. Siç do të deklaronte edhe vetë në Gjykatë, me 21 shtator 2018, Syzana Zogëjani e kishte vrarë bashkëshortin e saj në vetmbrojtje, kishte marrë fëmijët dhe ishte kthyer në Kosovë. Gjykatat në Kosovë e refuzuan argumentin e saj të vetmbrojtjes dhe e shpallën fajtores për vrasje të rëndë Syzana Zogëjanin duke e dënuar me 25 vjet burgim.

Në nëntor 2020, pas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, QIKA kishte mbështetur kërkesën e mbrojtjes së Suzanës për rigjykim drejtuar Gjykatës Supreme me arsyetimin se gjykimi ishte përfshirë në shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe se në arsyetim përdorej gjuhë denigruese ndaj të akuzuarës.³⁷

Pas Aktgjykimit të Kushtetueses që e ktheu lëndën në rivendosje, në tetor 2023, para Gjykatës Themelore në Prishtinë, rifilloi gjykimi ndaj Syzana Zogëjani Sekiraqës. Në seancën e parë të rigjykimit ajo ajo kishte deklaruar: "Unë i pranoj veprimet e mia, unë ato s'i kom ba prej qejfit, s'i kom ba me dashje, kom dashtë me mbrojtë veten tem, po nuk e pranoj kualifikimin ligjor".³⁸

36 Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim K1161/21, 7 gusht 2023, paragrafi 131, https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/08/ki_161_21_av_shq.pdf

37 QIKA, Rigjykim për Syzanën – analizë e rastit, nëntor 2020, <https://qika.org/wp-content/uploads/2021/02/RIGJYKIM-PER-SUZANEN-FINAL-2.pdf>

38 Betimi për Drejtësi, E akuzuara për vrasjen e burrit në Francë thotë se I pranon veprimet por që vrasjen e bëri për ta mbrojtur veten, 2 tetor 2023, <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-per-vrasjen-e-burrit-ne-france-thote-se-i-pranon-veprimet-por-qe-vrasjen-e-beri-per-ta-mbrojtur-veten/>

Qasja në strehimore

Strehimoret vazhduan të jenë të qasshme vetëm për gratë e mbijetuara të dhunës në familje që i raportojnë abuzuesit në Polici. Kjo, sipas raportit të Amnesty International, paraqet pengesë të madhe dhe i lë pa mbështetje të mbijetuarat që nuk janë të gatshme apo ato që nuk duan t'i raportojnë abuzuesit e tyre.³⁹

Funksionimi i strehimoreve ndër vite është rrezikuar nga mungesa e financimit adekuat shtetëror dhe nga vonesat sistematike në alokimin e fondeve.⁴⁰ Në vitin 2023 Qeveria dyfishoi buxhetin për strehimoret, mirëpo nuk bëri zgjidhje të qëndrueshme për financimin e tyre sidomos në tre muajt e parë të vitit. Në fund të dhjetorit 2023 dhe në fillim të janarit 2024, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) raportoi se strehimoret që ofrojnë shërbime rezidenciale për viktimat e dhunës në familje, fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe viktimat e trafikimit u përballën me frikën e mungesës së fondeve dhe mos funksionimit të shërbimeve sociale. Sipas RrGK, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës të mbajtur me 27 dhjetor 2023, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati, kishte refuzuar kërkesën për financim të këtyre strehimoreve. RrGK kërkuan zgjidhje emergjente nga Qeveria.⁴¹

Pas reagimeve nga organizatat e shoqërisë civile, me 10 janar 2024, Qeveria e Kosovës aprovoi mbështetjen financiare shtesë për strehimoret dhe OJQ-të e licencuara në vlerë prej 287 mijë euro.⁴²

Mbështetja pas qëndrimit në strehimore

Gjatë vitit, 23 nga 38 kërkuese të mbijetuara të dhunës në familje kishin përfituar mbulimin e shpenzimeve të qirasë nga programi i Komunës së Prishtinës për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje. Ndërkaq, 11 kërkueseve iu kishte refuzuar kërkesa për mbështetje për shkak se kërkesën për udhërmbrojtje e kishin paraqitur para shumë vitesh ose kishin paraqitur kërkesë pa e kompletuar do-

39 Amnesty International, Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje, faqe 45, <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7123/2023/en/>

40 Amnesty International, Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje, faqe 47, <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7123/2023/en/>

41 Rrjeti i Grave të Kosovës, RrGK i bën thirrje Qeverisë të adresojë nevojat e strehimoreve dhe shërbimeve tjera sociale, 28 dhjetor 2023, <https://womensnetwork.org/sq/rrgk-i-ben-thirrje-qeverise-te-adresoje-nevojat-e-strehimoreve-dhe-sherbimeve-tjera-sociale/>

42 Ministria e Drejtësisë, Ndahen 287 mijë euro për shërbime sociale dhe familjare, 10 janar 2024, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,3186>

kumentacionin e nevojshëm. Në korrespondencë me QIKA-n, sa i përket kushtëzimit të kohëzgjatjes së mbështetjes së të mbijetuarave të dhunës në familje me kohëzgjatjen e urdhrit mbrojtës, Komuna e Prishtinës u përgjigj:



Kohëzgjatja [e mbështetjes] lidhet me udhërmbrojtës, sepse kjo përkrahje bëhet më qëllim të krijimit të lehtësirave të përdtishmërisë së viktimës, nga e cila supozohet që për aq kohë sa e njejta mund të jetë në rrezik ose e cënuar, është mjaftueshëm e mbështetur thirrur nëpërmjet këtij vendimi. Kjo përkrahje fuqizon ato dhe u mundëson pavarësi në jetën e tyre. Përndryshe, kurdo që skadon mbështetja e drejtpërdrejtë si viktimë e dhunës, Departamenti i Mirëqenies Sociale ka masa të tjera nëpërmjet të cilave mbështet personat/individët në nevojë sociale – siç mund të jetë subvencionimi i mëtejme i qirasë së banimit, i cili mund të jetë në kohëzgjatje deri në 5 vite.»⁴³

QIKA konsideron se kohëzgjatja e mbështetjes financiare për të mbijetuarat e dhunës në familje nga Komuna nuk do të duhej të lidhej me kohëzgjatjen e urdhrit mbrojtës. Urdhri mbrojtës lëshohet për parandalimin e vazhdimin të dhunës, ndërsa mbështetja financiare e ka për qëllim plotësimin e nevojave financiare të të mbijetuarave të dhunës në familje gjatë largimit nga situatat abuzive. Qasja e zhvillimit dhe të zbatimit të politikave lokale e qendrore duhet të ketë në qendër të mbijetuarën, pra që ta bëjë sa më të lehtë për të të marrë mbështetjen që i duhet për të dalë nga situata e dhunës dhe për të jetuar një jetë të pavarur. Prandaj mbështetja ose vazhdimi i mbështetjes duhet të organizohet në mënyrën më të lehtë të mundshme për të mbijetuarat, pa i shtyrë ato të aplikojnë disa herë për pako të ndryshme të mbështetjes.

43 QIKA, Përgjigjeje e Komunës së Prishtinës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 9 shkurt 2024.

Po ashtu, duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për informimin e të mbijetuarave në familje për mundësinë e kërimit të mbështetjes nga Komuna. Numri i kërkesave për mbështetje (vetëm 38 për një vit) duket i ulët në krahasim me nevojën për mbështetje të të mbijetuarave të dhunës në familje që dëshmohet nga niveli i ulët i punësimit të gratë dhe numrin gjithnjë në rritje të raportimeve të dhunës në familje.

Në kohën e shkrimit të këtij raporti, nuk ekzistonte një program në nivel nacional për të mbështetur financiarisht të mbijetuarat e dhunës në familje.

Qasja në punësim e grave që kanë përjetuar dhunë në familje

Në nëntor, Qeveria lansoi “Masën për mbështetjen e punësimit të grave viktime të dhunës”, me anë të së cilës u zotua se do të subvencionojë 70 për qind të pagës së tyre.⁴⁴ Megjithatë, në shkurt 2024, Ministria e Drejtësisë nuk ofroi informata lidhur me atë se sa gra kanë përfituar nga kjo masë, “pasi që procesi i përfitimit kërkon verifikim dhe bashkëpunim edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Financave të Punës dhe të Tregtisë.”⁴⁵ Mbeti e paqartë se pse nuk mund të bëhej “verifikimi dhe bashkëpunimi” ndërmjet ministrive, duke marrë parasysh edhe se Ministria e Drejtësisë e bën koordinimin ndër-institucional të përgjigjes ndaj dhunës në familje.

Në lidhje me informimin e publikut dhe të mbijetuarave të dhunës në lidhje me këtë masë, në një përgjigje ndaj kërkesës së QIKA për qasje në informata zyrtare, Ministria e Drejtësisë tha se kishte dërguar njoftime tek Strehimoret dhe Qendrat për Punë Sociale për t’i informuar lidhur me masën e re, si dhe që në linjën telefonike të Ministrisë që shërben për njoftimin lidhur me këtë masë (0800 100 10), kishin telefonuar dhjetëra vajza dhe gra për të marrë informata.⁴⁶ QIKA konsideron se Qeveria duhet të bëjë përpjekje më të mëdha që ta informojë publikun lidhur me masën e punësimit të grave viktime të dhunës në familje, pasi që është e re, dhe ta promovojë edhe më shumë numrin e telefonit për qasje në informata lidhur me këtë masë.

44 Ministria e Drejtësisë, Raport përmbledhës i fushatës «16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore 2023», janar 2024, faqe 11, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/E732F69C-56BD-4CEC-ABEA-04BE3F757839.pdf>. Radio Evropa e Lirë, Qeveria ndan fonde për punësimin e grave të mbijetuara nga dhuna, 7 dhjetor 2023, <https://www.evropaelire.org/a/lansohet-masa-per-punesimin-e-grave-te-mbijetuara-te-dhunes-/32719733.html>

45 QIKA, Përgjigje e Ministrisë e Drejtësisë ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 22 shkurt 2024.

46 QIKA, Përgjigje e Ministrisë e Drejtësisë ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 22 shkurt 2024.

E drejta në kompensim

Gjykatat nuk shfrytëzuan bazën ligjore për t'i dhënë kompensim të dëmit të shkaktuar nga dhuna në familje të mbijetuarave të dhunës në familje. Analiza e një mostre sistematike të 197 aktgjykimeve penale për raste të dhunës në familje, të pesë viteve të fundit nga Amnesty International tregoi se vetëm 5.1% nga 255 të mbijetuarave në vendimet gjyqësore kërkuan kompensim të dëmit të shkaktuar nga veprat penale. Ndërkaq, gjykatat nuk vendosën për asnjërën kërkesë për kompensim të dëmit në procedurë penale por vetëm i referuan ato në proces civil, duke mos e shfrytëzuar autorizimin ligjor që ia ofronte Kodi i Procedurës Penale. Sipas raportit, shpesh të mbijetuarat hezitojnë të fillojnë proces të ri civil meqë janë të sflitura nga proceset e shumta gjyqësore që i duhet t'i vijnë siç janë seancat për rastin e dhunës në familje, të besimit të fëmijëve, të zgjidhjes së martesës e të ndarjes së pasurisë. Amnesty International rekomandoi që gjykatat ta shfrytëzojnë bazën ligjore për t'i dhënë kompensim në kohë, gjithpërfshirës dhe në përputhje me dëmin të mbijetuarave të dhunës në familje.⁴⁷

Në shtator 2023, Instituti i Kosovës për Drejtësi publikoi një raport ku ishin analizuar 50 aktgjykime penale për dhunë në familje të Gjykatave Themelore të tre viteve të fundit dhe erdhi në përfundim të ngjashëm. Të mbijetuarat kërkuan kompensim vetëm në tre nga 50 rastet, ndërkaq Gjykatat nuk vendosën për kërkesat për kompensim në asnjërin rast.⁴⁸

Dënimet joadekuate ndaj abuzuesve të grave

Shqyrtimi sistematik nga Amnesty International i vendimeve gjyqësore që përfshinte 218 persona të dënuar për dhunë në familje tregoi se nga dënimet ishin joadekuate në raport me peshën e veprës penale. Nga 218 të pandehur, shumica dërmuese e të cilëve ishin burra, 74% pranuan dënim me burgim me kusht, 45% pranuan gjobë dhe 20% gjobë me kusht.

47 Amnesty International, Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje, faqe 45, <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7123/2023/en/>

48 Instituti i Kosovës për Drejtësi, Kompensimi i viktimave të dhunës në familje, faqe 9, shtator 2023, <https://kli-ks.org/kompensimi-i-viktimave-te-dhunes-ne-familje/>

Në gjashtë raste ishin akuzuar e dënuar edhe burri edhe gruaja. Analiza e rrethanave faktike e këtyre rasteve nga Amnesty International ra në përfundim se viktimat e parë, që në të gjitha rastet ishte gruaja, mund t'i jetë përgjigjur dhunës fillestare të burrit. Shumica e këtyre vendimeve nuk e shqyrtuan fare mundësinë e vetmbrojtjes dhe i dënuan të dy njëlloj.⁴⁹

Me ndryshimet e Kodit Penal të Kosovës u parashikun dy dënime plotësuese për personat që kryejnë veprën penale të dhunimit dhe të dhunës në familje. Përkatësisht: "Neni 2.a.1. ndalimi i blerjes në ankande të shitjes së pronave publike, aseteve publike apo licencave që jepen nga një autoritet publik në çfarëdo shërbimi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet; Neni 2.a.2. ndalimi i aplikimit si investitor strategjik dhe çdo formë tjetër e përfitimit nga privilegjet që jepen nga legjislati në fuqi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet."⁵⁰

QIKA konsideron që informatat publike lidhur me këto ndryshime legjislative nuk ofrojnë qartësi lidhur me ndikimin që parashihet ta kenë këto dënime plotësuese në dhënien e dënimeve adekuata për dhunë në familje. Një studim më i thellë është i nevojshëm për ta matur ndikimin e dënimeve plotësuese.

49 Amnesty International, Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje, faqe 61-68, <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7123/2023/en/>

50 Ligji nr. 08/I-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 06/I-074 Penal i Republikës së Kosovës, Neni 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=84232>

Dhuna seksuale

Sipas të dhënave zyrtare të Policisë gjatë vitit 2023, janë raportuar gjithsej 76 raste të ngacmimit seksual, 90 raste të dhunimit dhe 65 raste të sulmit seksual.⁵¹

Në nëntor 2022, Qeveria e Kosovës ka miratuar Protokollin shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale për qëllim të qartësimit të roleve të ndryshmet të ofruesve të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës seksuale. Sipas të dhënave të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës, në periudhën 2019-2021, fëmijët vajzat ishin më së shpeshti të viktimat të dhunimit seksual. Në protokoll përcaktohen parimet me të cilat duhet të udhëheqet trajtimi i të mbijetuarave të dhunës seksuale dhe mes tjerash përcaktohen veprimet dhe hapat që duhet të ndërmerren nga policia, nga mjeku ligjor, mbrojtësi i viktimave, prokuroria, gjykatat dhe punonjësit socialë.⁵²

Një ndryshim pozitiv që solli ligji i ri për mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore ishte që nga tetori 2023, të mbijetuarat e dhunës seksuale që nuk kanë lidhje qoftë familjare apo tjetër me abuzuesit mund të kërkojnë urdhër mbrojtës.⁵³ Para hyrjes në fuqi të këtij ligji, udhër mbrojtës në proces civil mund të kërkonin vetëm personat që përjetojnë dhunë në familje.

Në dhjetor hynë në fuqi ndryshimet e Kodit Penal përmes së cilave u kriminalizua testimi i virgjërisë.⁵⁴

51 QIKA, Përgjigje e Policisë së Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 5 prill 2024.

52 Qeveria e Kosovës, Protokollin shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, 23 nëntor 2022, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/04F016B5-48F2-4DB3-A595-D320114AC25D.pdf>

53 Ligji Nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=83131>

54 Ligji Nr.08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Neni 236(A), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84232>



JO I BJEN JO!

Kjo kampanjë është financuar nga QSKA me mbështetje Ekonomike të Këshillit të Evropës. Përkrahja e integritetit midis shteteve të bashkuar dhe bashkëpunimi në tërësi të Evropës. Përkrahja e integritetit midis shteteve të bashkuar dhe bashkëpunimi në tërësi të Evropës.

qika | qendra e informimit dhe bashkëpunimit

SEKSI PA PËLQIM ËSHTË PËRNDHUNIM!


Cdo formë e detyrimit ose manipulimit të një personi tjetër për të kryer marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj/ro është dhunë. Kjo vlen edhe për personat të cilët janë në marrëdhënie martesore.

ÇKUD KJETER NUK ËSHTË PËLQIM SIPS TJETË?

Hej, nuk jeni prind!
Vetëm PO/Jo, Po/Jo
Kështu 30 ditë (shprehje e vullnetit)

Nuk jam e sigurtë!
Nëse e 13.6
Shprehje e vullnetit
Nëse e 13.6
Shprehje e vullnetit

qika | qendra e informimit dhe bashkëpunimit



Dhunimi seksual

Në shkurt, Gjykata e Apelit e anuloi vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë që dënoi katër të akuzuarit për dhunimin seksual, trafikimin dhe keqpërdorimin për pornografi të një vajze 11 vjeçare në gusht 2022. Sipas Aktgjykimit, i Akuzuari Ekrem Rexhepi u dënua me 15 vjet burgim, ndërsa tre të miturit, G. R. me 9 vite burg ndërkaq, G. J. dhe Xh. S. secili me nga 8 vite burgim. Njëri ndër të akuzuarit, Shkëlqim Kameri, ishte liruar nga akuza në mungesë provash.⁵⁵ Rasti tani është sjellë prapë para Gjykatës Themelore në Prishtinë për rivendosje dhe ende nuk përfunduar procesi gjyqësor.⁵⁶ Në gusht 2022, pas publikimit të rastit në media në Prishtinë dhe Tiranë ishin organizuar protesta me thirrje për mbrojtjen e vajzave dhe grave nga dhuna.⁵⁷

Dhuna seksuale gjatë luftës

Gjatë vitit 2023, 211 personave iu njoh statusi viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës, prej tyre ishin 190 gra dhe 21 burra, ndërsa 91 personave iu refuzua kërkesa për njohje, prej tyre 82 gra dhe nëntë burra. Nga viti 2018 kur ka filluar njohja zyrtare, kanë aplikuar gjithsej 2048 persona, ndërkaq Qeveria ia ka njohur këtë status gjithsej 1,628 personave, 1540 grave dhe 89 burrave.⁵⁸

Gjykata e Apelit ia rriti dënimin Zoran Vukotić-it nga 10 në 13 vite burgim për kryerjen e krimeve kundër popullatës civile dhe dhunimin seksual të një gruaje në Kosovë në vitin 1999.⁵⁹ Ky ishte rasti i parë që

55 Kallxo.com, 40 vjet burg për 4 të akuzuarit për dhunimin e 11-vjeçares, 24 shkurt 2024, <https://kallxo.com/lajm/40-vjet-burg-per-4-te-akuzuarit-per-dhunimin-e-11-vjecares/>

56 Koha, Rasti i 11-vjeçares: Apeli anulon vendimin e Themelores për hedhjen e aktakuzës për 5 të akuzuar, 26 janar 2023, <https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/363073/rasti-i-11-vjecares-apeli-anulon-vendimin-e-themelores-per-hedhjen-e-aktakuzes-per-5-te-akuzuar>

57 Radio Evropa e Lirë, Protesta pas dhunimit të 11-vjeçares, 30 gusht 2022, <https://www.evropaelire.org/a/protesta-pas-dhunimit-te-nje-vajze-/32010947.html>; Radio Evropa e Lirë, Protestë në Prishtinë kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave 31 gusht 2022, <https://www.evropaelire.org/a/proteste-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave-/32012374.html>

58 Qeveria e Kosovës, Përgjigje e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata zyrtare nga QIKA, 21 mars 2024.

59 Gjykata e Apelit ia rrite Zoran Vukotić-it dënimin nga 10 në 13 vjet. 20 April 2023, <https://apeli.gjyqesori-rks.org/2023/04/18/aprovohet-pjeserisht-si-e-bazuar-ankesa-e-prokurorise-speciale-te-republikes-se-kosoves-ndryshohet-aktgjykimi-i-gjy-kates-themelore-ne-prishtine-departamenti-special-ps-nr-28-2022-i-dates-11/>

dikush dënohet nga gjykata për dhunën seksuale në Kosovë gjatë luftës. Në maj, Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzën e parë në mungesë të të akuzuarit për dhunim gjatë luftës në Kosovë.⁶⁰

Qeveria e Kosovës zgjati afatin e aplikimit për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë deri me 15 maj 2025. Personave që iu njihet ky status marrin pension prej 230 euro në muaj.⁶¹ Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës kërkoi nga Qeveria që për këtë aplikim të mos ketë fare afat.⁶²

Ngacmimet seksuale

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës gjatë vitit janë raportuar 76 raste të ngacmimit seksual. Përkundër kërkesës së QIKA, Policia nuk ka ofruar të dhëna të qarta për rastet e ngacmimeve të ndara sipas gjinisë dhe etnisë.⁶³

Një hulumtim nga Kosovo 2.0 zbluloi se 1 nga 3 apo 100 studentë/e nga mbi 300 të anketuar nga Universiteti i Prishtinës kishin përjetuar ngacmim seksual në universitet. Vetëm pesë raste të ngacmimit seksual ishin raportuar në Këshillin e Etikës që nga hyrja në fuqi e Rregullores për mbrojtje nga ngacmimi seksual në Universitetin e Prishtinës në mars të vitit 2021. Këshilli i Etikës së Universitetit të Prishtinës nuk i dha qasje Kosovo 2.0 në vendimet e nxjerra.⁶⁴

60 Koha, Ngrihet aktakuza e parë në mungesë për dhunim gjatë luftës në Kosovë, 2 maj 2023, <https://www.koha.net/ar-beri/375974/ngrihet-aktakuza-e-pare-ne-mungese-per-dhunim-gjate-luftes-ne-kosove/>

61 Kallxo, Shtyhet për dy vjet afati i aplikimit për njohjen e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës, 8 mars 2023, <https://kallxo.com/lajm/shtyhet-per-dy-vjet-afati-i-aplikimit-per-njohjen-e-statusit-te-viktimes-se-dhunes-seksuale-gjate-luftes/>

62 Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Komunikatë për media, 5 shkurt 2024, <https://www.facebook.com/QKRMT/posts/pfbid09Qd2caRUPMsfpPGQj7RJGkd4AFiV9tqw7JKjMz6ycBw9nozbyVK61uLrVAEWaM8hI>

63 QIKA, Përgjigjje e Policisë së Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 5 prill 2024.

64 Kosovo 2.0, Ngacmimi seksual kalon pa u ndëshkuar në Universitetin e Prishtinës, 1 nëntor 2023, https://kosovotwopointzero.com/ngacmimi-seksual-kalon-pa-u-ndeshkuar-ne-universitetin-e-prishtines/?fbclid=IwAR25fAZ_RbUDf62dEikXR0eV-WReoEvMff-my2WV35YYjzYNo8w1u412jIBE

Lëvizja Studentore Feministe i realizoi disa aksione protestuese duke kërkuar publikimin e vendimeve të Këshillit të Etikës për ngacmime seksuale.⁶⁵

Në nëntor, afro 300 nxënës të shkollës “Nazmi Zhegrova” në fshatin Stanoc të Ulët në Komunën e Vush-
trrisë bojkotuan mësimin, ndërsa prindërit e tyre protestuan para shkollës kundër mosndeshkimit të një
mësimdhënësi që po akuzohej për ngacmim seksual.⁶⁶

Një hulumtim nga QKSGJ nga 600 gra të anketuara që punonin në sektorin privat vetëm 10% deklaruan
se kanë qenë viktime të ngacmimeve seksuale në punë. Ndërkaq punëtoret e grupmoshave më të reja
nga 18-34 vite ishin më të prirura të deklaroinin se ngacmimi seksual është i pranishëm në vendin e
punës.⁶⁷

65 Qika.org, LFS kërkon transparencë dhe llogaridhënie për rastet e ngacmimeve seksuale në UP
20 nëntor 2023, <https://qika.org/lfs-kerkon-transparence-dhe-llogaridhenie-per-rastet-e-ngacmimeve-seksuale-ne-up/>

66 Qika.org, Prindërit protestojnë kundër mosndeshkimit të mësimdhënësit që akuzohet për ngacmim seksual,
21 nëntor 2023, <https://qika.org/prinderit-protestojne-kunder-mosndeshkimit-te-mesimdhenesit-qe-akuzohet-per-ngacmim-seksual/>

67 QKSGJ, Ngacmimi seksual në sektorin privat në Kosovë, 29 shtator 2023,
[chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://kgscenter.net/site/assets/files/1847/ngacmimi_seksual_ne_sek-
torin_privat_ne_kosove_1.pdf](chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://kgscenter.net/site/assets/files/1847/ngacmimi_seksual_ne_sek-torin_privat_ne_kosove_1.pdf)

Dhuna përmes teknologjisë informative

Një sondazh i realizuar në mes të janarit dhe qershorit 2023 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Gratë (UN Women) gjeti se 43.3% e 1,007 grave mbi 18 vjeçe në Kosovë kishin përjetuar ndonjë formë të dhunës përmes teknologjisë informative në jetën e tyre. Disa nga format e dhunës përmes teknologjisë ishin: pranimi i përmbajtjes së papërshtatshme seksuale përmes rrjeteve sociale; presioni për të ndarë mesazhe dhe imazhe sugjestive seksuale; informata private të zbuluara pa miratim siç janë fotot, informatat e kontaktit dhe përmbajtje eksplicite seksuale; thyerja e llogarive private apo e webfaqeve, e me radhë.⁶⁸

Gratë në sferën publike

AGK regjistroi 74 raste të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj mediave, numër rekord të rasteve në krahasim me vitet e kaluara. Nga të gjitha rastet, 11 ishin ndaj gazetareve gra.⁶⁹

Deputetja Saranda Bogujevci, mbrojti nga foltorja të drejtën e secilës grua në shfrytëzimin e Fertilizimit të Asistuar Mjekësor (FAM), pavarësisht statusit martesor. Pas shprehjes së këtij qëndrimi ajo u bë cak i sulmeve verbale online.⁷⁰ Në mars, Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist, realizoi grafite në

68 UN Women, The Dark Side for Digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia, page 40, October 2023, https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2024-01/research-tf-vaw_full-report_24-january2.pdf

69 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Rastet, qasur me 31 janar 2024, <https://agk-ks.org/rastet/>

70 Koha.net, Dështon sërish projektligji për IFV-në, deputetët e pushtetit të ndarë, 22 shkurt 2023, <https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/410276/desh-ton-serish-projektligji-per-ifv-ne-deputetet-e-pushtetit-te-ndare>

Kuvendin e Kosovës si kundërpërgjigje ndaj zërave kundërshtues të Ligjit për FAM si dhe deklaratës së Saranda Bogujevcit në Kuvend: "E drejta mbi trupat tanë na takon neve dhe vetëm neve!"⁷¹

Në korrik, Flutura Kusari, juriste e medias dhe aktiviste për lirinë mediave u bë cak i një fushate sharjesh online, komenteve seksiste lidhur me pamjen e saj. Një numër i madh i personave publik shprehën solidaritet me të, mes tjerash pati reagim nga Rrjeti i Grave të Kosovës, Ambasadori i Gjermanisë dhe Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë.⁷²

Me ndryshimet e nëntorit në Kodin Penal u kriminalizua dhuna ndaj grave që ushtrojnë ose që kandidate për ushtrimin e funksioneve publike. Dhuna ndaj tyre, qoftë psikike, seksuale, ekonomike që ka për qëllim frikësimin ose detyrimin për të vepruar kundër vullnetit të tyre, dënohet me gjobë dhe me burgim nga gjashtë muaj në tri vjet.⁷³

AGK regjistroi 74 raste të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj mediave, numër rekord të rasteve në krahasim me vitet e kaluara. Nga të gjitha rastet, **11 ishin ndaj gazetaresve gra.**

71 Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist, Porosi Rrahmanëve të Kuvendit e Shoqërisë Kosovare: nëse s'keni uterus, msheleni gojën!, 10 mars 2023, <https://www.facebook.com/kolektivifeminist/posts/pfbid0vguZjZvoezwYvPwUoAnt3ptYaAcYA6sQPcH-7CXGqfLC7JmFJekzq84yypxLGQ1Gkl>

72 Flutura Kusari, Postim falënderimi ndaj ambasadorëve në Facebook, 7 korrik 2023, <https://www.facebook.com/kusari/posts/pfbid0z4W7mnJGCwekn6CqDEypVVCYiQsNYxR5c8KWQF6CCH5M9aNrvWEAFggETbAPIJzXI>

73 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 248A, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84232>

Femicidi

Kjo pjesë përmbledhë zhvillimet më të rëndësishme për rastet e femicidit të vitit 2023 dhe raste të mëparshme të femicidit që vazhdojnë të jenë pazgjidhura.⁷⁴ Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2023, gjithsej katër gra dyshohet se janë vrarë nga burrat. Në prill, në Pejë, një burrë dyshohet se ka vrarë nënën e tij⁷⁵, në gusht, në Fushë Kosovë dyshohet se një burrë ka vrarë partneren e tij, shtetase argjentinase⁷⁶, në korrik, në Lipjan dyshohet se një burrë ka vrarë gruan, djalin dhe pastaj edhe veten⁷⁷ si dhe në muajin nëntor, në Prishtinë dyshohet se një person e vrau me armë zjarri një grua gjersa ajo ishte në makinë me bashkëshortin e saj dhe fëmijët e tyre.⁷⁸ Rasti i fundit i përmendur është rasti i vrasjes së Liridona Ademajt, zhvillimet e të cilit shpjegohen më poshtë.

74 Informatat janë të ndara në rastet e zgjidhura të femicidit, për të cilat ka pasur një proces gjyqësor që ka marrë epilog me vendim të Gjykatës së Apelit ose të Gjykatës Supreme, dhe në rastet e pazgjidhura të femicidit, për të cilat është duke u zhvilluar një proces gjyqësor ose për të cilat organet e ndjekjes nuk kanë arritur të arrestojnë e të sjellin para drejtësisë vrasësit. Ka mundësi që në vitet në vijim të ketë ndryshim në rastet e zgjidhura të femicidit për shkak të kthimit të procesit në rivendosje nga Gjykata e Apelit ose Gjykata Supreme siç ka ndodhur në disa raste publike të femicidit.

75 Evropa e lirë, Vrasje e rëndë në Pejë, dyshohet se djali vrau nënën, 14 prill 2023, <https://www.evropaelire.org/a/vrasje-peje-djali-nenen/32364340.html>

76 Koha Net, Vritet shtetasja argjentinase në Fushë-Kosovë, arrestohet i dyshuari, 2 gusht 2023, <https://www.koha.net/kronike-e-zeze/387205/fushe-kosove-shtetasja-argjentinase-vdes-pasi-bie-nga-lartesia-e-nje-objekti/>

77 Insajderi, Babai vret gruan e djalin, pastaj edhe veten- detaje nga ngjarja në Lipjan, 28 korrik 2023, <https://insajderi.org/babai-vret-gruan-e-djalin-pastaj-edhe-veten-detaje-nga-ngjarja-ne-lipjan/>

78 Klan Kosova, Vritet një grua në Prishtinë, 29 nëntor 2023, <https://klankosova.tv/vritet-nje-grua-ne-prishtine-video7/>

Rastet e zgjidhura të femicidit

Lirije Qerimaj (48 vjeçare)

Në janar, Gjykata e Apelit e vërtetoi dënimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë prej 24 vitesh me burgim ndaj Skender Qerimajt për vrasjen e bashkëshortes së tij Lirije Qerimaj në Llaushë, Skenderaj me 6 janar 2022.⁷⁹ Institucioni i Avokatit të Popullit kishte konstatuar pas një hetimi zyrtar, se prokuroria e shtetit dhe policia kishin dështuar ta mbrojnë të drejtën në jetë të Lirije Qerimajt pasi nuk kishin kryer vlerësim adekuat të rrezikut dhe nuk kishin siguruar masa mbrojtës e për të.⁸⁰ Këshilli Prokurorial i Kosovës e shpalli fajtores prokuroren e rastit për shkelje disiplinore lidhur me rastin dhe i dha vërejtje publike me shkrim.⁸¹

79 Koha.net, Apeli vërteton dënimin prej 24 vjetësh burgim ndaj të dënuarit për vrasjen e gruas në Llaushë, 11 janar 2023, <https://www.koha.net/kronike-e-zeze/360889/apeli-verteton-denimin-prej-24-vjetesh-burgim-ndaj-te-denuarit-per-vrasjen-e-gruas-ne-llaushë/>

80 Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti ex-officio nr. 13/2022 (lidhur me detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën për jetë dhe për të siguruar mbrojtjen nga dhuna në familje), 21 korrik 2022, <https://oik-rks.org/2022/07/22/raport-ex-officio-132022-perki-tazi-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-pe-te-mbrojtur-te-drejte-ne-jete-dhe-per-te-siguruar-mbrojtje-nga-dhuna-ne-familje/>, para. 4.

81 Këshilli Prokurorial i Kosovës, Vendimi KPK/Nr.602/2022, 14 Prill 2022, <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Vendim%20nr.%20700%202022%2C%20Stojanka%20Kasalovic.pdf>

Hatije Dina (54 vjeçare)

Në korrik, Gjykata e Apelit vërtetoi dënimin me 15 vite burgim të Gjykatës Themelore në Prizren ndaj Ilir Haxhijajt, për veprën penale lëndim i rëndë trupor me pasojë vdekjen.⁸² Haxhijaj në maj 2019, kishte ushtruar dhunë brutale ndaj bashkëshortes së tij Hatije Dina, duke e goditur në të gjitha pjesët e trupit dhe duke ia goditur kokën në asfalt në Samdrazhë të Suharekës. Hatije Dina kishte ndërruar jetë në spital si pasojë e lëndimeve, dy javë pas sulmit.⁸³ Haxhijaj ishte dënuar edhe më parë për këtë lëndë nga Gjykata në Prizren dhe Apeli me 15 vite burgim efektiv në shkurt 2021, mirëpo Gjykata Supreme e kishte kthyer rastin në rigjykim sipas kërkesës së mbrojtësit të të akuzuarit.⁸⁴ Pas vendimit të Gjykatës së Apelit, nuk pati raportime mbi atë se a ka paraqitur mbrojtësi i Haxhijajt kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj Gjykatës Supreme.

Sebahate Morina (44 vjeçare)

Në mars, Gjykata Kushtetuese publikoi aktgjykimin me të cilin konstatoi se Sebahate Morinës, iu shkëlqeu drejta në jetë për shkak se shteti dështoi ta mbronte.⁸⁵ Ish-bashkëshorti, Lulzim Sopi, e vrau Sebahate Morinën në vitin 2021 në Prishtinë dhe më pas kreu vetvrasje. Ky është rasti i parë ku Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të detyrimeve të Kosovës nën Konventën e Stambollit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe është rasti i dytë, pas vendimit për rastin e Diana Kastratit (2013) ku Kushtetuesja po ashtu konstatoi shkeljen e të drejtës në jetë për shkak të dështimit të mbrojtjes shtetërore të viktimave

82 Betimi për drejtësi, Apeli vërtetoi dënimin 15 dite për Ilir Haxhijajn, 7 korrik 2023, <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-me-15-vite-burgim-ndaj-te-akuzuarit-se-ushtrroi-dhune-ndaj-bashkeshortes-e-cila-me-pas-vdiq-ne-qkuk/?fbclid=IwAR3C81L-85FRFcqgq7QGY26JEspNzjofjK9XHCcZLGH7hBMx2qclmucwcQzA>

83 Kallxo.com, Suharekasi mohon akuzat për vdekjen e gruas, djali i viktimës përletet në gjykatë, 17 dhjetor 2019, <https://kallxo.com/ligji/suharekasi-mohon-akuzat-per-vdekjen-e-gruas-djali-i-viktimes-perlotet-ne-gjykatel/>

84 Betimi për drejtësi, Apeli vërtetoi dënimin 15 dite për Ilir Haxhijajn, 7 korrik 2023, <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-me-15-vite-burgim-ndaj-te-akuzuarit-se-ushtrroi-dhune-ndaj-bashkeshortes-e-cila-me-pas-vdiq-ne-qkuk/?fbclid=IwAR3C81L-85FRFcqgq7QGY26JEspNzjofjK9XHCcZLGH7hBMx2qclmucwcQzA>

85 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykim rastin nr. K1129 / 21 Parashtues Velerda Sopi, 22 mars 2023, <https://gjk-ks.org/decision/leresim-i-kushtetutshmerise-se-veprimeve-dhe-mosveprimeve-te-gjykes-themelore-ne-gjilan-prokurorise-themelore-ne-gjilan-stacionit-poligor-ne-gracanice-dhe-prokurorise-themelore-n/>

të dhunës në familje.⁸⁶ Në rastin e Sebahate Morinës, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Policia dhe Prokuroria (i) nuk reagues menjëherë, (ii) nuk e bënë një vlerësim të mirëfilltë dhe të menjëhershëm të rrezikut, (iii) ishin në dijeni ose duhet të kishin qenë në dijeni për rrezikun e menjëhershëm real ndaj jetës së Sebahates, meqenëse ish-bashkëshorti i saj ishte dënua më parë për dhunë në familje ndaj saj dhe megjithatë (iv) nuk kishin marrë masa parandaluese për mbrojtjen dhe parandalimin e privimit nga jeta të Sebahates.⁸⁷

Në prill, aktivistet feministe dhe organizatat e të drejtave të grave kërkuan dorëheqjen ose shkarkimin e prokurorit dhe zyrtarëve policorë përgjegjës për rastin.⁸⁸ Këshilli Prokurorial i Kosovës zhvilloi procedurë disiplinore me anë të së cilës e gjeti përgjegjëse për shkelje disiplinore Prokuroren Hava Krasniqi dhe ia shqiptoi masën disiplinore "Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë për qind (30%) për një vit".⁸⁹ Policia e Kosovës nuk kishte zhvilluar hetime të reja pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese sepse në 2021 kur kishte ndodhur rasti, Drejtoria për Hetime të Brendshme kishte zhvilluar një hetim ndaj zyrtarëve përgjegjës kishte shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje me shkrim".⁹⁰

86 Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim, Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 26 shkurt 2013, <https://gjk-ks.org/decision/gzim-dhe-makfire-kastrati-kundr-gjykats-komunale-n-prishtine-dhe-keshillit-gjyqsor-t-kosovs/>

87 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykim rastin nr. KI129 / 21 Parashtruese Velerda Sopi, 22 mars 2023, <https://gjk-ks.org/decision/leresim-i-kushtetutshmerise-se-veprimeve-dhe-mosveprimeve-te-gjykates-themelore-ne-gjilan-prokurorise-themelore-ne-gjilan-stacionit-policor-ne-gracanice-dhe-prokurorise-themelore-n/>

88 QIKA, Shteti fajtor për vrasjen e Sebahate Morinës, 5 prill 2023, <https://qika.org/activities/shteti-fajtor-per-vrasjen-e-sebahate-morines/>

89 Kallxo.com, Kërkohet shkarkimi i prokurorit të rastit të Sebahate Morinës, 5 prill 2023, <https://kallxo.com/lajm/kerkohet-shkar-kimi-i-prokurorit-te-rastit-te-sebahate-morines/>

90 Policia e Kosovës, Përgjigjje e Policisë së Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata përmes korrespondencës elektronike, 3 maj 2024.

Rastet e pazgjidhura të femicidit

Liridona Ademaj (30 vjeçare)

Në nëntor, një person e vrau me armë zjarri Liridona Ademajn gjersa ajo ishte në makinë me bashkëshortin e saj dhe fëmijët e tyre. Gjykata Themelore në Prishtinë caktoi masën e paraburgimit ndaj katër personave, përfshirë bashkëshortin e saj, Naim Murselin, si i dyshuar për organizimin e vrasjes.⁹¹ Në kohën e shkrimit të këtij raporti ende nuk ishte ngritur aktakuzë ndaj të dyshuarve. Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist dhe aktiviste feministe të pavarura organizuan një aksion simbolik para Pallatit të Drejtësisë në dhjetor me mbishkrimin: “Nuk ka paqe, pa sigurinë e grave.”⁹² Me 5 dhjetor u mbajt një marsh protestues në Prishtinë ku u kërkua “organizim gjithëpopullor në ç’rënjosjen e patriarkatit që po dhunon e vret vajzat e gratë në Kosovë” si dhe që femicidi dhe dhuna ndaj vajzave dhe grave të trajtohet si urgjencë kombëtare.⁹³

91 Koha.net, Një muaj paraburgim për të arrestuarin e katërt në rastin e Liridona Ademajt, 11 dhjetor 2023, <https://www.koha.net/kronike-e-zeze/402112/nje-muaj-paraburgim-per-te-arrestuarin-e-katert-ne-rastin-e-liridona-ademajt/>

92 Koha.net, “Nuk ka paqe pa sigurinë e grave”, aksioni simbolik para seancës për vrasjen e Liridona Ademajt, 3 dhjetor 2023, <https://www.koha.net/arberi/401243/vrasja-e-liridona-ademajt-aksion-simbolik-para-gjykates/>

93 Kolektivi Feminist Mbrëmë, nën thirrjen “Nuk ka paqe pa sigurinë e grave” protestuam dhe kërkua organizim gjithëpopullor, 6 dhjetor 2023, <https://www.facebook.com/kolektivifeminist/posts/pfbid02YWj2VEgjnoeqXxi2BLkhECdVnFYMwEGNxypkQr4ctcfRokcB2ihqRvCYMhzLxvTKl>

Maria Clara Urdangaray (27 vjeçe)

Me 2 gusht 2023, Maria Clara Urgandaray, shtetase argjentinase vdiq pasi kishte rënë nga lartësia e një objekti. Prokuroria ka kërkuar paraburgimin e partnerin të saj, Endrit Nikaj, shtetas Zviceran, i cili po dyshohet për vrasjen e saj . Me 7 maj 2024, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte vazhduar paraburgimin e të dyshuarit Endrit Nikaj edhe për dy muaj.⁹⁴

Marigona Osmani (18 vjeçare)

Në gusht, Gjykata Themelore në Ferizaj dënoi me burgim të përjetshëm Dardan Krivaqën për vrasjen e Marigona Osmanit, ndërsa Arbër Sejdiu e dënoi me 15 vite burgim për ndihmë në vrasje. Me këtë vendim, gjykata e liroi Krivaqën nga akuza për dhunim dhe Sejdiu për ndihmë në kryerjen e dhunimit dhe për Sejdiun e rikualifikoi veprën panale nga bashkëkryerje të vrasjes, në ndihmë në vrasje. Pas ankesave nga Prokuroria e Shtetit, familja e Marigona Osmanit dhe mbrojtësit e të akuzuarve, Gjykatën e Apelit, në shkurt 2024, e anuloi vendimin e themelores dhe e ktheu rastin në rivendosje në Gjykatën Themelore në Ferizaj.⁹⁵

Gjykata e Apelit konstatoi se në Aktgjykimin e shkallës së parë kishte pasur shkelje esenciale të procedurës penale, përkatësisht se (1) “aktgjykimi i ankimuar është i paqartë, i pakuptueshëm dhe jo në harmoni me dispozitat ligjore të cilat e formojnë veprën penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtorë”; (2) në aktgjykim Krivaqa shpallet fajtor për “privimin nga jeta e personit tjetër në mënyrë mizore dhe dinake” ndërsa motivet e xhelozisë dhe mizoria e kryerjes së veprave penale është dashur të vërtetohet nga ekspertët; (3) mungojnë arsyet për faktet vendimtare thelbësore për vërtetimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarve që duhet të eliminohen gjatë rigjyimit të lëndës; ndërsa (4) ankesa e familjes së Marigonës u cilësua si jolëndore, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale.⁹⁶

94 Kallxo.com, Rrëfimi i nënës së argjentinases që dyshohet se u vra në Kosovë, 26 maj 2024, <https://kallxo.com/lajm/rrrefimi-i-nenes-se-argjentinases-qe-dyshohet-se-u-vra-ne-kosove-video/>

95 Koha.net, Dardan Krivaqa is sentenced to life imprisonment, Arbër Sejdiu to 15 years of imprisonment, 4 August 2023, <https://www.koha.net/en/ktv-evening-news/387499/Dardan-Krivaqa-is-sentenced-to-life-imprisonment%2C-Arber-Sejdiu-is-sentenced-to-15-years-of-imprisonment/>

96 Gjykata e Apelit, Anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, ndaj të akuzuarve D.K dhe A.S, ndërsa çështja kthehet në rigjykim, 23 shkurt 2024, <https://apeli.gjyqesori-rks.org/2024/02/23/anulohet-aktgjykimi-i-gjykates-themelore-ne-ferizaj-departamenti-per-krime-te-renda-ndaj-te-akuzuarve-d-k-dhe-a-s-ndersa-ceshtja-kthehet-ne-rigjykim/>

Mirjeta Zeka (41 vjeçare)

Nuk u raportuan zhvillime të reja për gjetjen e Mirjeta Zekës, e cila është shpallur e zhdukur që nga 31 marsi 2019 në Mitrovicë. Në vitin 2020, me kërkesë të vëllezërve të saj, Njësia për Kërkim Shpëtim e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës kishte bërë kërkime për gjetjen e trupit të saj pranë lumit Ibër, në Mitrovicë, por pa sukses. Për këtë rast i dyshuar ishte bashkëshorti i Mirjeta Zekës, Nehat Shabani, i cili ishte intervistuar nga Policia. Vëllezërit e Mirjetës kishin ngritur dyshime se ai mund ta ketë vrrarë Mirjetën duke përmendur mes tjerash se ai nuk e kishte lënë Mirjetën as të kishte telefon dhe as të komunikonte lirshëm me vëllezërit e saj.⁹⁷ Prokuroria Themelore në Mitrovicë i kishte pezulluar hetimet por nuk i ka publikuar arsyet për këtë vendim. Një prokuror i kishte thënë Betimit për Drejtësi se nuk kanë mundur t'i intervistojnë vajzat e të ndjerës pasi që ato ishin në Gjermani.⁹⁸

Donjeta Pajazitaj (24 vjeçare)

Në prill, Gjykata Supreme morri vendim për lirimin nga akuza të Naser Pajazitajt, i dënuar paraprakisht me burgim të përjetshëm nga Gjykata Themelore në Ferizaj për vrasjen e Donjeta Pajazitaj në vitin 2015. Për këtë rast ishin zhvilluar tre procese gjyqësore. Gjykata Themelore në Pejë, pas gjykimit të parë, e kishte liruar prej akuzës Pajazitajn, mirëpo Gjykata e Apelit e kishte anuluar aktgjykimin dhe e kishte kthyer lëndën në rivendosje. Pas gjykimit të dytë, Gjykata Themelore në Pejë e kishte shpallur fajtor Naser Pajazitajn dhe e kishte dënuar me burgim të përjetshëm. Këtë aktgjykim e kishte anuluar Gjykata Supreme, ndërkaq lënda ishte dërguar për rivendosje në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Kjo gjykatë, pas gjykimit të tretë, e kishte shpallë fajtor Naser Pajazitajn dhe e kishte dënuar me burgim të përjetshëm. Gjykata Supreme e anuloi vendimin e Themelores duke e liruar Pajazitajn me arsyetimin se nuk kishte pasur pro-

97 Radio Televizioni 21, Mitrovicë: Mirjeta Zeka e zhdukur që nga marsi 2019, 30 maj 2021, <https://rtv21.tv/mitrovica-mirjeta-zeka-e-zhdukur-qe-nga-marsi-2019-video/>; Klan Kosova, Direkt nga Mitrovica flet vllau i të zhdukurës, Mirjeta Zeka, 2020, https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch_permalink&v=265108788264024

98 Betimi për Drejtësi, Mirjeta Zeka gati që katër vjet e zhdukur, Prokuroria ende pa asnjë rezultat për zbardhje të rastit, 17 dhjetor 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/mirjeta-zeka-gati-qe-kater-vjet-e-zhdukur-prokuroria-ende-pa-asnje-rezultat-per-zbardhje-te-rastit/>

va të drejtpërdrejta që e dëshmonin fajësinë e tij dhe dënimi i me burgim të përjetshëm ishte mbështetur në prova rrethanore.⁹⁹

Nuk u raportuan zhvillime të reja për arrestimin dhe sjelljen para drejtësisë të vrasësit Donjeta Pajazitajt.

Diana Kastrati (27 vjeçare)

Nuk u raportuan zhvillime të reja për gjetjen dhe sjelljen para drejtësisë të vrasësit të Diana Kastratit. Adnan Jashari, ish-partneri i Diana Kastratit, është i dyshuari kryesor për vrasjen e saj me armë zjarri në Prishtinë me 18 maj 2011. Pas vrasjes, ai u arratis nga Kosova dhe Policia nuk arriti ta arrestojë.

Me kërkesën e prindërve të Diana Kastratit, Gëzim dhe Makfire Kastrati, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar shkeljen e të drejtës në jetë nga Gjykata Komunale e Prishtinës për shkak se Diana kishte kërkuar nga gjykata urdhër mbrojtës emergjent për ta urdhëruar Adnan Jasharin të mos i afrohej e të mos e shqetësonte, ndërsa gjykata nuk e kishte lëshuar urdhrin mbrojtës brenda një kohe të arsyeshme.

Prindërit e Diana Kastratit kishin parashtruar edhe padi për kompensim të dëmit jo-material ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës. Në korrik 2019 Gjykata Themelore në Prizren e kishte miratuar padinë dhe kishte urdhëruar kopmensionimin në vlerë prej 95,000 euro. Në shkurt, Gjykata e Apelit e zbriti shumën e kompensimit të dëmit jo-material në 30,000 euro për përgjegjësisë së shtetit për shkeljen e të drejtës në jetë të Diana Kastratit.¹⁰⁰ Prindërit e të ndjerës, Gëzim dhe Makfire Kastrati, reaguan ndaj këtij vendimi duke e akuzuar Gjykatën e Apelit se po “tenton ta shtrembërojë dhe t’i ikë përgjegjësisë (...) për kompensim të dëmit jo-material për dhimbjet

99 Koha.net, Publikohet aktgjykimi me të cilin u lirua i dënuari për vrasjen e Donjeta Pajazitajt, 2 maj 2023, <https://www.koha.net/arberi/375972/publikohet-aktgjykimi-me-te-cilin-u-lirua-i-denuari-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitajt/>

100 Koha.net, Apeli vendos që prindërit e Diana Kastratit të dëmshpërblehen me 30 mijë euro, 10 shkurt 2023, <https://www.koha.net/arberi/365190/apeli-vendos-qe-prinderit-e-diana-kastratit-te-demshperblehen-me-30-mije-euro/>

e përjetuara shpirtërore për shkak të vet fajit të tyre”.¹⁰¹ Në qershor, Gjykatën Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën e tyre për revizion të vendimit të Apelit.¹⁰²

Në përgjigjet ndaj kërkesës për informata zyrtare të dërguar nga QIKA në vitin 2022, Ministria e Drejtësisë së Kosovës dhe Prokuroria Themelore e Prishtinës kanë deklaruar se shteti i Spanjës ka refuzuar të bëjë ekstradimin e Adnan Jasharit në Kosovë, i dyshuari kryesor për vrasjen e Diana Kastratit. Prandaj Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte pezulluar hetimet për rastin e vrasjes së Diana Kastratit.¹⁰³

101 Gëzim Kastrati dhe Makfire Kastrati, Postim në Facebook, 12 shkurt 2023, <https://www.facebook.com/gezim.kastrati/posts/pfbid02fc3izGXWGGpNpdV61ezMssvNp5ZpP2DsNfM3VJRww9QqPdx9pT6fYbtUpP3u8E43I>

102 Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykim Rev.nr.176/23, 15 qershor 2023.

103 QIKA, Përgjigje e Prokurorisë së Shtetit dhe e Ministrisë së Drejtësisë, 17 maj 2022. https://qika.org/activities/drejtesia-e-mun-guar-11-vite-nga-vrasja-e-diana-kastratit/?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMATAAR1LlKzO182bZvZC5G_dzS6oULkQzt3HpYigGQ-O_5GIU-QUsdmmAYWQM9WM_aem_AfOdJom7bJgpuho7o_ZHHwhygGA-Z-PFluxq90AMfu2xQR-zZ4y5fJXW4OoVpenOfq8hdx2QXNfEiTY-P2YwHD6CP



QENDRA PËR INFORMIM,
KRITIKË DHE AKSION - QIKA